

*Përgjegjës në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

1. Organizon dhe koordinon veprimtarinë e sektorit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij.
2. Përgjegjës për kontrollin e punës lidhur me mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare të ASIG, që nga planifikimi korrekt i shpenzimeve operative, investimeve dhe zbatimin e procedurave financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Kontrollon veprimtarinë administrative financiare dhe siguron përdorimin efektiv të fondeve të institucionit, përfshi fondin e pagave si edhe për të gjitha transaksionet financiare që lidhen me nevojat e institucionit dhe në marrëdhënie me të tretët.
4. Kontrollon dhe siguron mirëadministrimin e pasurisë së ASIG për kryerjen në afat të inventarizimit të vlerave monetare dhe materiale.
5. Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse në ASIG për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e PBA-së në tregues sasiore dhe buxhetore, për çdo program buxhetor.
6. Monitoron periodikisht zbatimin e buxhetit në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara në ligjin e buxhetit dhe udhëzimet përkatëse për hartimin dhe zbatimin e buxhetit.
7. Përgjegjës për kontrollin, monitorimin dhe përgatitjen e dokumentacionit nga ana financiare, gjatë procesit të prokurimeve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
8. Përgjegjës për kontrollin e pasqyrave financiare vjetore të përgatitura nga specialistët.

#### **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor në Shkenca Ekonomike.
- Të ketë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune në profesion.

- Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve,
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese;
- Të ketë njohuri për parimet dhe praktikatat administrative;
- Të njohë kudirin ligjor në fuqi për financat, buxhetin dhe prokurimet publike.
- Të njohë mirë gjuhën angleze dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.
- Të njohë programet kompjuterike bazë dhe programet që lidhen me kontabilitetin..
- Vlerësohen certifikimet për sa më lart.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-2)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 19.01.2024, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nd. 2, H.3, Kati 2, Tiranë ose në adresën e e-mailit [info@asig.gov.al](mailto:info@asig.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja (nëse ka)
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.